



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV-të
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 144/14
Prishtinë, më 26.02.2014, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Muhamet Musafa, Albana Fetoshi dhe Duda Balje.

Munguan: Safete Hadergjonaj, Xhevdet Neziraj dhe Sevdije Lama.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini dhe Dashurije Canolli.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Mahir Yagcilar – Ministër i Administratës Publike, Naim Fetahu – Zv.Ministër i Financave, Agim Krasniqi – Drejtor i Departamentit të Buxhetit në MF, Ramiz Lladrovci – anëtar i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, Avdi Kameroli – nga ministria e infrastrukturës, Aleksandra Fehinger dhe Rejhane Zylfijaj nga GIZ, monitorues nga Zyra e Presidentes.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Zëvendës Kryetar i parë i Komisionit.

R e n d i i d i t ë s:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 19.02.2014;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-221 për Institutin e Kosovës për Administratë Publike me amendamentet e Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës me amendamentet e Komisionit funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-232 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës me amendamentet e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-246 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit me amendamentet e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;
7. Shqyrtimi i Propozimit të Panelit Seleksionues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për plotësimin e një pozite për anëtar joekzekutiv të Bordit të BQK-së;
8. Shqyrtimi i Raporti të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2013;
9. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi: njoftojë se kemi marrë një kërkesë nga komisioni funksional për zhvillim ekonomik që më urgjencë të shqyrtohet Projektligji për Themelimin e Agjencionit të Navigacionit Ajror, pasi që është ndër ligjet që duhet miratuar nga obligimet që dalin nga MSA. Për atë që kam shikuar dekaltratën e ndikimit financiar, projektligji është vlerësuar të ketë një kosto buxhetore shtesë prej 21 milion euro. Siq e shihni na duhet ndihma e ministrit të financave sepse është një kosto jashtëzakonisht e madhe dhe kemi nevojë me pas informata më të hollësishme. Mendimi imë është që me e lën për ndonjë mbledhje tjetër.

Hykmete Bajrami: theksoj se pajtohem më propozimin që mos me qenë në rendin e ditës së sotme dhe të kalohet në mënyrë të ngutshme. Kërkova edhe prej administratës, që kur të shqyrtojmë këtë, të ftohet ministri i financave dhe ministrja e integriteteve evropiane dhe të arsyetoj se qfare lidhje ka ky projektligj, me marrëveshjen e stabilizim-asociimit. Absolutisht në emër të marrëveshjes nuk jemi na ata që e luftojmë dhe shpërndajmë miliona, por le të vie ministresha dhe ministri janë të dy antarët e të njëjtës qeverie, ti ndëgjojmë dhe pastaj marrim vendimin.

Latif Gashi: theksojë se është mirë të marrim një mendim nga ministria e financave dhe nëse është ligji urgjent të shqyrtojmë, unë mendoj se e vonojmë vetën pak, sepse ne prapë duhet të shqyrtojmë dhe nuk jom për me e shtye këtë ligj.

Kryesuesi: theksoi unë mendoj se nuk duhet me trajtue në mënyrë të ngutshme. Ne do ta trtajojmë, por është më mirë të lëmë për mbledhjen e radhës.

Latif Gashi pasi që e kemi përfaqësuesin edhe sponsorizuesin e këtij projektligji, ta ndëgjojmë dhe meqë është një ligj më rëndësi, propozoj që me konsensus të vendosim me trajtue në këtë takim.

Kryesuesi: thekson se unë e konsideroj ligjin të rëndësishëm por jo të veçantë që të hyn në qështje urgjente dhe të trajtohet në një shpejtësi kur është ligji që përmban koston ndër më të lartë në vitet e fundit. Unë propozoj që të ftojme njerëzit kompetent që të tregojnë rëndësinë e këtij ligji.

Latif Gashi: meqë e kemi prezent përfaqësuesit kompetent, më mirë ti ndëgjojmë dhe nëse është urgjent e shyrtojmë por nëse nuk është e lëmë për javën tjetër në mbledhjen tjetër.

Muhamet Mustafa: thekson se po kuptojë që është një qështje më urgjente, por nëse e shtyjme për mledhjen tjetër, besojë që nuk ka me pas pasoja deri atëherë.

Avdi Kamerolli: thekson se parimisht po ju njoftoj se përmes këtij ligji themelohet një prej agjensioneve më të rëndësishme në Kosovë, për shkak se lidhet drejtpërdrejt me sigurinë e sektori të aviacionit civil. Në Raportin e Progresit parashihet si prioritet urgjentë, në afatin sa më të shpejtë, me e krye këtë ligj dhe ndërlidhet ekskluzivisht me MSA-në. Agjencioni do të jetë i vetëfinancuar, nga të hyrat që krijon nga taksat, përkatësisht nga licencimi i kontrolluesve.

Kryesuesi: mendojë se ne si deputet duhet të kemi informacione për këtë qështje, dhe duhet të harmonizimin me ministrinë e financave sepse kostoja nuk është paraparë në KASH. Ne do të kontaktojmë edhe me komisionin funksional, do të marrim informacione prej ministrit të integriteteve, por nuk dua që deputetët të nënshtrohen një presioni të panevojshëm. qështjes të ditëve apo të orëve. Përndryshe jemi të gatshëm të thirrjmë edhe mbledhje brenda kësaj jave nëse është atëherë urgjente, por jo ta trajtojmë sot sepse jemi të papërgaditur.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryesuesi i mbledhjes, konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 19.02.2014

Kryesuesi konstatoi se procesverbali i datës 19.02.2014, miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-221 për Institutin e Kosovës për Administratë Publike me amendamentet e Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mahir Yagcilar: njoftoj se se IKAP-i, deri tash ka qenë i rrregulluar me një rrregullore të UNMIK-ut dhe është propozuar që tani të rregullohet me ligj. IKAP-i është i themeluar dhe ka buxhetin e ndarë, por kostoja financiare e vlerësuar është të fuqizohet puna e këtij instituti, sidomos në organizimin më të shumëta të trajnimeve. Përndryshe këtë institut do të vazhdojë aktivitetin me kapacitetet që ka, por sigurisht që me këtë buxhet, niveli i trajnimeve do të jetë më i pakët. Por do të ishte më mirë edhe nga aspekti i reformave në administratën publike të krijojmë një standard më të lartë dhe të kemi një buxhet më të madh sa i përket administratës publike.

Kryesuesi: thekson se kemi të bëjmë me një projektligj që është vlerësuar se krijon një kosto buxhetore shtesë për 3 vite, 780,898 euro dhe kryesisht mjetet janë për mallra edhe shërbime, pasi që aty lidhet fusha e trajnimeve që bënë ky institut dhe meqë ministria e administratës publike merrë përsipër se instituti do të vazhdojë aktivitetin me mjetet buxhetore të lejuara, mendojë se ne mund të përkrahim.

Albana Fetoshi: pyeti në cilat projekte konkrete shkojnë në mallra dhe shërbime, çka konkretisht shpenzohen shumë?

Mahir Yagcilar: sqaroi se të gjitha trajnimet edhe testimet konsiderohen si mallra dhe shërbime dhe pagesat bëhen nga kjo kategori.

Albana Fetoshi: a nënkupton se edhe investimet kapitale siç i keni palanifikuar, hyjnë në mallrave dhe shërbimeve?

Mahir Yagcilar: sqaron se trajnimet hyjnë në mallra edhe shërbime dhe nuk ka investime kapitale.

Kryesuesi: njoftoj se për investime kapitale është paraparë shuma prej 50,000 euro, e kryesisht pjesa tjetër shkon për trajnime që paguhen prej mallrave edhe shërbimeve

Latif Gashi: pasi që i kemi prezent përfaqësuesit e ministrisë së financave, është mirë të marrim mendimin e tyre për koston e vlerësuar. Kishte me qenë mirë nëse nuk është paraparë kostoja për vitin 2014, a mundet që në vitet 2015 e 2016, të ndahet buxhet shtesë, në rast se ministria e administratës publike nuk mundet me i mbulue këto shpenzime.

Agim Krasniqi: theksoi se jo vetëm për këtë ligj por edhe disa ligje tjera kemi me i trajtu kemi me e pas të njëjtën qështje. Ministria e Financave e ka për obligim me tregue se mbi bazën e projektligjeve të ministris sponzoruese sa janë kërkesat shtesë. Ne jemi në fazën e caktuar kur bëhen ndryshimet e politikave dhe e kemi shumë të qartë si qeveri se do të kemi jo rritje të buxhetit në shpenzime operative po kursim për politikat e reja. Ne momentin që është një gjendje e tillë, kur e kalojmë një ligj është shumë

e qartë që puna e parë është riprioritizimi i kërkeseve që parashtrohen, sepse nuk ka mundësi me u rrit buxheti qysh bëhen kërkesat. E dyta në momentin që bëhet riprioritizimi i kërkesave na kemi me i përkrah, përndryshe për këtë projektligj, ne kemi thënë se kjo është kostoja shtesë, por këtë kosto duhet me e mbulu ministria.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxorri këtë

Rekomandim

Zbatimi i Projektligjit nr.04/L-221 për Institutin e Kosovës është i përballueshëm për buxhetin e Kosovës dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës me amendamentet e Komisionit funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Naim Fetahu: thekson se ministria e financave vleron se ky projektligj do të ketë kosto buxhetore shtesë për buxhetin e Kosovës në vitin 2014 do të jetë shuma 600 euro, e për vitin 2015 dhe 2016 nga 51,254 euro në vit, kjo kosto është e paraparë në kategori ekonomike për paga dhe mëditje, dhe do të ketë një rritje të një numri të punëtorëve për 2 punëtorë. Për zbatimin e këtij legjislacioni të gjitha shpenzimet të paraqitura edhe ato që nuk janë parapa në këtë vlerim e që mund të paraqiten gjatë zbatimit të tij dhe duhet të absorbohen brenda ndarjeve buxhetore të zyrës së auditorit të përgjithshëm.

Kryesuesi: thekson se gjatë hartimit të buxhetit për vitin 2014, ne e kemi nda mjetet e nevojshme me një amendament që është miratuar në seancë dhe kostoja e vlerësuar është pjesë e buxhetit. Mirëpo kemi probleme me disa nene të këtij projektligji. Është neni 3, paragrafi 8 që flet për pagën dhe shtesat e auditorit dhe për mua nuk është problematike paga apo përqindja, por problem është shtesa, pasi që ne nuk mund të caktojmë pagë por jo shtesë dhe unë konsideroj që duhet bërë një amendament këtu. Problemi tjetër është te paragrafi 3 i nenit 13, ku thuhet se zyra kombëtare e auditimit ka pavarësi financiare, dhe kjo mund të na sjell telashe gjatë kohës së aprovimit të buxhetit. Ata mundën me pas pavarësi menaxheriale dhe administrative, por jo financiare, ndërkohë pavarësinë në menaxhimin e buxhetit secili institucion e ka.

Latif Gashi: theksoi se është mirë parasegjithash me ditë rëndësinë se a mundet të krahasohet ky institucion me gjykatën kushtetuese, që realisht konsiderojë se jo, dhe nuk besojë që auditori duhet ta marrë një pagë ekuivalente prej 90% të kryetarit të gjykatës kushtetuese. Në këtë e kemi kalkuluar dhe ka dalë se paga e kryetarit të gjykatës kushtetuese është mbi 4,000 euro në muaj që mendojë se edhe se është shumë e lartë dhe nuk do të duhej të merrej si krahasim as nga institucionet tjera. Unë besojë që nuk duhet t'ia lejojmë këtë lloks askujt.

Muhamet Mustafa: mendojë se zyrja e auditorit ka një funksion shumë të rëndësishëm dhe ne duhet të bëjmë gjithçka që kjo zyrë të ruaj nivelin e nevojshëm të pavarësisë dhe profesionalizmit. Mendojë që auditori ka përgjegjësi shumë të madhe dhe duhet të jetë profesionist, prandaj duhet të jemi shumë të kujdesshëm mos ta lëndojmë zyrën e auditorit të përgjithshëm me një vendim të tillë. Sa i përket përqindjes mendojë se është e pranueshme dhe krahasimi me gjykatën kushtetuese është real, pasi që detyra kryesore e auditorit është mbikëqyrja e shpenzimit të parasë publike dhe duke pasur të bëjë me financat publike, është një punë mjaftë me përgjegjësi. Duhet të jetë e riformuluar siq është edhe për kryetarin e gjykatës

kushtetuese. Sa i përket nenit për pavarësinë financiare, ndoshta mund të riformulohet, por se duhet garantuar se kjo zyrë ka mjete të mjaftueshme buxhetore në kryerjen e aktiviteteve të saja.

Kryesuesi: ky institucion është organ që i jep llogari Kuvendit dhe kjo është e rregulluar, por mos me ra Kuvendi në situata të palakmuese gjatë përgaditjes së buxhetit, siq e kemi përvojën me gjykatën kushtetuese, unë e konsideroj se paragrafi 3 i nenit 13 duhet të riformulohet. Në takimin që kam qenë me z. Zhbogar që është biseduar për ligjet që dalin nga MSA, është thënë se ndër ligjet me urgjencë që duhet miratuar është edhe ligji për funksionarët e lartë publik. Po besojë se do ta kemi këtë projektligj shumë shpejtë, i cili projektligj do të përcaktojë dhe kategorizojë nivelin e pagave për të gjithë zyrtarët e lartë publik, përfshirë edhe auditorin e përgjithshëm, prandaj nuk kemi nevojë që me këtë ligj të përcaktojmë pagën e auditorit.

Latif Gashi: unë mendoj se është një ligj me rëndësi të veçantë po nuk jam dakord se duhet ti lejohet kjo pagë auditorit, madje nuk duhet ti lejohet as kryetarit të gjykatës e as auditorit.

Hykmete Bajrami: thekson se pajtohet me propozimin siç është në projektligj për faktin se institucioni i auditorit është një ndër institucionet më të rëndësishme dhe konsideroj se përgjegjësi më të madhe se të auditorit nuk ka, pavarësia e tij shifet edhe te niveli i pagës. Nëse kemi një pagë të ulët, nuk do të konkurojë ansjë person i pavarur dhe to do të kemi servila të partive politike që do të shkojnë dhe mandej do të kemi raporte të auditorit të njëanshme për një sërë institucioneve. Mendoj se duhet ta lëmë propozimin siç e ka sjellë komisioni funksional. Ne mundemi me i rregullue pagat në momentin që vjen ligji për pagat e funksionarëve të lartë publik për të gjitha agjencionet, por në këtë moment nuk mundemi me thënë se përgjegjësia e kryetarit të gjykatës kushtetuese është më e madhe se e auditorit të përgjithshëm. Unë mendoj që për institucione kaq të rëndësishme, ne nuk duhet me e prur diskutimin në nivel të pagës dhe të impaktit financiar. Të gjithë e dijmë se punën profesionale që ka bërë ky institucion. Ne duhet të interesohemi që të ruajmë pavarësinë e këtij institucioni, pavarësisht se kush ka me qenë në qeveri. Agjencionet tjera nuk i kemi të pavarur, i kemi servil të partive politike.

Kryesuesi: qështja e rëndësisë të institucioneve është relative, ne i ndëgjuam se thanë që është agjensioni më i rëndësishëm në Kosovë dhe me pyet zyrën e rregullatorit të energjisë elektrike, kanë me thënë se ky është më i rëndësishmi. E ne i dijmë specifikën e secilit institucion e dijmë përgjegjësinë që e ka edhe auditori, por a duhet me qenë paga me këtë ligj, apo po e presim ligjin për rregullimin e pagave të funksionarëve të lartë publik.

Hykmete Bajrami: unë mendoj se duhet me e caktue me këtë ligj pagën sepse ky ligj do të hynë në fuqi para ligjit për pagat e funksionarëve të lartë publik. Nëse nuk përcaktojmë pagën tani, si komision kemi me pas një kërkesë prej zyrës së auditorit për me e caktu pagën e tij.

Latif Gashi: unë mëndo ta lëmë pagën siq ka qenë, e qështjen e pagave të zyrtarëve të lartë do ta rregullojë ligji i ardhshëm. Ka punuar me atë rrogë por edhe tashe tutje le të punojë.

Agim Krasniqi: sqaroi se ky projektligj është hartuar para se me u ba projektligji për funksionarët e lartë publik, dhe në momentin që hyn në fuqi ky ligj, aty përcaktohet paga e kryetarit të gjykatës kushtetuese, e auditorit dhe të gjithë funksionarëve të lartë publik.

Latif Gashi: pyeti a është kërkesë e auditorit apo e ministrisë për rritjen e pagës?

Agim Krasniqi: sqaroi se auditori nuk ka drejtë me qenë sponzorizues i projektligjit, por e këtij PL e ka bërë ministria së bashku me auditorin dhe normal që auditori ka insistuar me e sigurue një pozitë me të mirë.

Kryesuesi: theksoi vlersimet e të gjithë neve janë se auditori e ka bërë punën mirë dhe nuk kemi vërejtje në raportet e auditorit, por nëse ai ka punu mirë me këtë pagë që e ka, po cili qënka qëllimi me ja ngrit pagën. Prandaj unë konsideroj se qështjen e pagës të auditorit të përgjithshëm nuk është dashtë me e rregullu me këtë ligj dhe ka bërë gabik ministria e financave që e ka pranue kjo qështje të futet në ligj. Propozojë se paragrafi 8 i nenit 3 të fshihet.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni me gjashtë vota Për (Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Albana Fetoshi dhe Duda Balje), një Kundër (Muhamet Mustafa) dhe një Abstenim (Hykmete Bajrami), propozoi amendament për heqjen e paragrafit 8 të nenit 3.

Alban Fetoshi: sa i përket paragrafit 3 të nenit 13, kam një propozim, që Zyra Kombëtare e Auditimit me pas të drejtë financiare në menagjimin e parave në mënyrë të pavarur.

Agim Krasniqi: thekson se qdo institucion e ka pavarësinë e për me menagjimin e financave të veta.

Kryesuesi: neni 3 pika 13 buxheti dhe llogaridhenja, propozimi imë është që zyra kombëtare e auditimit të ketë pavarësi menagjieriale administrative si dhe burime të mjaftueshme njerzore materiale dhe financiare.

Latif Gashi: pajtohem që të heqim fjalën “financiareë”, le të mbesin të gjitha tjerat ashtu siç janë.

Muhamet Mustafa: thekson se këtu fjala pavarësi financiare e menagjieriale nuk është aq esenciale për mua, por esenca është që ky mos me qenë i lënduar prej asaj se sa i propozohet në buxhet. Kështu që duhet me qenë se zyra e auditorit, me pas pavarësinë e vet dhe burime të mjaftueshme financiare që e mbështesin pavarësinë e këtij institucioni.

Agim Krasniqi: njoftoi se shumë prej ligjeve për institucionet e pavarura, në të cilat është shkruar pavarësia financiare, na kanë sjellur probleme në përgaditjen e buxhetit. Të gjitha agjensionet e pavarura i përgjigjen Kuvendit dhe këtë e përcakton ligji për menagjimin e financave publike.

Ramiz Lladrovci: thekson se komisioni për mbikqyrjen e financave publike e ka shqyrtuar dhe e ka amendamentuar projektligjin dhe unë kam qenë udhëheqësi i grupit punues. Pas draftimit, kemi marrë disa vërejtje nga Bashkimi Evropian, por vërejtjet e Komisionit Evropian nuk qëndrojnë fare dhe BE ka rënë në lajthitje nga auditori i përgjithshëm, pasi që shumë prej qështjeve të paraqitura në vërejtje nuk i kemi prekur në draftin që ka ardhur nga Qeveria. Për shumicën e qështjeve jemi marrë vesh edhe me auditorin edhe me propozuesin gjatë punës në grupin punues. Nuk jemi pajtuar që auditori të ketë të drejtën e auditimit të disa institucioneve, veprimtaria e të cilave konsiderohet sekrete, siç është agjencia kosovare e intelligence, ku qështja e funksionimit rregullohet me ligj të veçantë. Ndërkohë ka lindur ideja që duhet me ia bënë një vend dikujt, por ne nuk bëjmë ligj për kërkon, por bëjmë ligj për Zyrën kombëtare të auditimit të Kosovës. Zyra e auditorit e ka bërë organogramin dhe punojnë në bazë të tij, ende pa u miratuar ligji. Janë paraparë shumë pozita, si asistent auditor, sekretar për një pjesë të stafit dhe jo kret zërrën, shofera për logjistikë dhe përkthyes, që normalisht se ne nuk i kemi përkrahur. Sa i përket pavarësisë financiare e ka të plotë, dhe nuk është cenuar me këtë ligj dhe projektbuxheti i saj kalon në qeveri dhe qeveria pastaj në Kuvend, i cili vendos përfundimisht për buxhetin e kësaj zyre. Kjo zyrë ka pavarësi të plotë operacionale

dhe i jep llogari vetëm Kuvendit që e ka themeluar dhe emëron auditorin e përgjithshëm. Ne i kemi pyetur edhe ekspertat e SIGMAS se a janë auditorët e shteteve të juaja punonjës civil dhe janë përgjigjur se po janë. Ne nuk kemi lejuar që stafi të zgjidhet sipas ligjit për shërbimin civil dhe të paguhet sipas ligjit të punës.

Hykmete Bajrami: ju të Partisë Demokratike qasjen që e keni ndaj auditorit ndaj, keqpërdorimeve të pozitave, do të duhej të keni një qasje të tillë ndaj krejt institucionet e jo veç për auditorin gjeneral, i cili është dëshmue që ka qenë institucion i panvarur deri në këtë pikë.

Latif Gashi: kisha pasur dëshirë që anëtarët e komisionit për buxhet e financa, pavarësisht se cilës parti i takojnë nuk duhet të jenë avokat për krejt mandatin të një institucioni në veçanti të auditorit gjeneral, qysh u vërejtë nga kolegja që ka qenë avokate e këtij institucioni gjithëherë. Nuk e di pse kjo mbrojtje kaq e madhe nuk bënë me lënë interesin e përgjithshëm e me mbrojtje diqka që realisht nuk egziston.

Albana Fetoshi: unë mendoj se vërejtjet e komisionit evropian nga ajo që na njoftoi kolegu paskan qenë të drejta sepse ata kanë dasht me iu dhënë më shumë kompetenca Zyrës së auditorit të përgjithshëm dhe propozimet e komisionit funksional, po shifet se se iu paskan cunguar disa të drejta që ish dashtë me i pas zyra e auditorit të përgjithshëm në qështjen e auditimit të disa institucioneve. E ato që tha deputeti deri më tani nuk qëndrojnë, pajtohem me rastin kur ka kërkuar shtesë materiale të tepërt. Ne edhe në programin tonë e kemi që paga nuk duhet të jetë shumë e ulët, dhe mendojë se sado që jetë e përcaktuar paga nuk e garanton pavarësin e institucionit, dhe nëse paga është shumë e ulët edhe atëherë degradon. Por edhe paga shumë e lartë nuk e garanton pavarësin e institucionit dhe kjo ka të bëjë me krejt kredibilitetin e atij institucioni që udhëheqin. Vërejtjet e Komisionit Evropian lidhur me cungimin e pavarësisë së auditorit ishte dashur të merren parasysh.

Kryesuesi: thekson se janë disa punë specifike shtetnore që i kanë disa institucione por nuk lejohet futja e duarve, dhe agjensioni intelektual i Kosovës e ka një fond të mjeteve që i përdorin vetëm ata është sekret. Zyra ka me pas burime të mjaftueshme, po pavarësi të plotë financiare nuk ka, sepse me pas pavarësin financiare nuk është i lidhur me asnjë institucion.

Muhamet Mustafa: thekson se pavarësi financiare mundet me qenë dy kuptimësi, ajo është në funksion të pavarësisë së zyrës dhe nuk mundet me kërkuar buxhet pa kufi, ndoshta të shtojmë në fund se kuvendi i siguron burime të mjaftueshme auditorit.

Latif Gashi: thekson se nuk është mirë e nuk kemi nevojë me thënë se i garanton kuvendi, kjo nënkuptohet. Kuvendi me ligj e ka themelur këtë zyrë e nuk ka të bëjë me qeveri kjo asgjë.

Kryesuesi: thekson se ne e kemi vetëm një amendament e duhet të përkrahet, e këto tjerat nuk i prekim është edhe në ligj se ata i nënshtrohen ligjit për menaxhimin e financave publike dhe rregullave që duhet të ndjek në procesin e buxhetit.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisionit nxorri këtë

Rekomandim

1. Projektligji nr.04/L-236 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës nuk përmban implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të paragrafit 8 të nenit 3.

2. Komisioni për Buxhet dhe Financa propozon amendament në Projektligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si në vijim:

Amendamenti 1

Në nenin 3, paragrafi 8 hiqet.

3. Amendamentet e propozuara nga Komisionin Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike për Projektligjin nr.04/L-236 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të amendamentit 3, përkatësisht paragrafit 4 që rregullohet me këtë amendament, për të cilën paragraf, Komisioni për Buxhet dhe Financa rekomandon që të hiqet.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-232 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës me amendamentet e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Kryesuesi: theksoi se kemi të bëjmë me një projektligj që është vlerësuar me kosto buxhetore shtesë prej 154,000 euro në vit dhe shtimin e 31 të punësuarve, por duhet pasur parasysh faktin se krijohen edhe të hyra vjetore prej 300,000 euro.

Naim Fetahu: thekson se ministria e financave ka vlerësuar se zbatimi i këtij PL do të ndikonë në buxhetin e republikës së Kosovës me rritje e shpenzime prej 154,000 euro, dhe rritje të punësuarve prej 31 pozita, që nuk janë të parapara në buxhetin e vitit 2014 dhe në KASH.

Pas sqarimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxorri këtë

Rekomandim

Zbatimi i Projektligjit nr.04/L-232 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, është i përballueshëm për buxhetin e Kosovës dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-246 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit me amendamentet e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxorri këtë

Rekomandim

Zbatimi i Projektligjit nr.04/L-246 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, është i përballueshëm për buxhetin e Kosovës dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

7. Shqyrtimi i Propozimit të Panelit Seleksionues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për plotësimin e një pozite për anëtar joekzekutiv të Bordit të BQK-së

Kryesuesi: theksoi se nga propozimi i panelit të BQK-së, shofim se ka emra të përsëritur, dhe nga CV-të e kandidatëve të propozuar shofim se ato janë të mangëta. Ne nuk mund të folim individualisht për secilin, pasi nuk kemi marrë pjesë në intervistim.

Muhamet Mustafa: duke ditur rëndësinë e veçantë të kësaj pozite dhe të Bankës Qendore, unë quditem me propozimet që po na vijnë. Janë disa gjëra që nuk shkojnë, kemi emra që vijën për herë të tretë dhe shkurt nuk jam i kënaqur dhe ka nevojë për sqarime në Panelin Bordin që i ka propozuar.

Latif Gashi: theksoi se kishte me qenë mirë të procedojmë në senacë, pavarësisht që i kemi vërejtjet për përsëritje të kandidatëve, dhe seanca është ajo që i voton apo jo. Kandidati i parë i ka 95 poena nuk mundemi me kontestu përgaditjen e tij profesionale, por le të jetë vullneti i deputetëve.

Kryesuesi: kandidatët i kanë përbushur kriteret ligjore dhe ne i procedojmë në senacë për votim dhe secili deputet e shpreh mendimin e vetë.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxorri këtë

Rekomandim

1. I rekomandohet Kuvendit, të përzgjedhë njërin prej kandidatëve për pozitën e anëtarit joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendore të Republikës së Kosovës, me votim të fshehtë, si në vijim:

**Sejdi Rexhepi,
Ramë Rexha,
Nuhi Ahmeti,
Agim Vishi,
Milaim Berisha**

2. Kandidati i përzgjedhur nga Kuvendi, t'i dërgohet Presidentes për miratim dhe emërim në pozitën e anëtarit joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendore të Republikës së Kosovës.

8. Shqyrtimi i Raporti të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2013

Kryesuesi propozojë që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Komisioni njëzëri votoi që pika e tetë të shtyhet për shqyrtim në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi: 12:30

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Zëvendë Kryetar i parë i Komisionit

Naser Osmani